



Republika e Kosovës
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Përsoneelit

01 Nr. 111-7605 dt. 05/02/2018



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Drenasit shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e dy (2) vendeve të lira të punës: një Doktor familjarë në QKMF-Drenas dhe një Farmacist në barnatoren e QKMF-së Drenas, këto vende të lira janë për kohë të pacaktuar.

Titulli i vendit të punës:

1. Një (1) Doktor Familjar në QKMF Drenas i përgjigjen menagjerit-drejtorit të QKMF-së.
2. Një (1) Farmacist në QKMF- Drenas , i përgjigjet menagjerit/ drejtorit të QKMF-së.

Përshkrimi i detyrave të punës:1) Punët dhe detyrat e punës për Doktorit Familjarë në KPSH: ofrimi i shërbimeve shëndetësore mbështetur në profesionalizëm, të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallime, etikën mjekësore humanizmin dhe respektimin e normave ligjore. 2) Punët dhe detyrat e punës të farmacistit në barnatorën e QKMF/Drenas (KPSH): Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve në barnatoren dhe depon qendrore të QKMF-së, përpilimi dhe realizimi i buxhetit vjetor për medikamente dhe material shpenzues, përgatitja dhe kontrolli i barërave dhe preparative që ndodhen në depo, mbikqyrë punën e infermiereve farmaceutik, kontrollon rregullisht afatin e vlefshmërisë së barërave etj.

Paga mujore baze: Doktor Familjar H-565 /1sipas OB
Farmacist H-565/1 sipas OB

- I. **Kushtet dhe kriteret:** Diplomë Universitare e noterizuar (për Doktorë familjarë – Fakulteti i Mjekësisë dhe për Farmacistë- Fakulteti i Farmacisë), Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, një dokument identifikues, si dhe çertifikata që kandidati nuk është nën hetime. Kandidati i cili përzgjidhet nga komisioni intervistues obligohet që mbrenda afatit të sjellë në DSHMS çertifikatën shëndetësore në të kundërtën do të nënshkruhet kontrata e punës me kandidatin e radhës për të cilin vlenë e njëjta rregullë
- II. **Orari i punës:** 40 orë në javë.
- III. **Kontrata e punës:** me kohë të pacaktuar
- IV. **Afati i konkursit** është 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, nëse dita fundit është ditë vikendi apo feste shtyhet për ditën e vijim.

Udhëzim: të gjithë kandidatët-aplikantët mund të aplikojnë sipas afatit të lartëshënuar, të marrin aplikacionet në Komunen e Drenasit, kati parë, sporteli nr 10-12 dhe t'i dorëzojnë në po të njëjtin nr te arkivit. Dokumentacionet e pa kompletuara dhe ato të arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, për zhvillim të intervistës do të njoftohen me kohë përmes web faqes së komunës së Drenasit si dhe njoftimit në hyrje të ndërtesës së Komunës së Drenasit .

U.D. Udhëheqëse e Përsoneelit
Hanumshahe Hajdini

